

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

NORMATIVAT DHE STANDARDET

për hapësirat shkollore, pajisjet dhe mjetet mësimore për shkollat fillore në
Republikën e Maqedonisë së Veriut

Shkup, 2025

*Bazuar në nenin 23, paragrafi 3, të Ligjit të Arsimit Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74/25), ministrja e Arsimit, me propozimin e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit me nr. 08-1041-/1 të datës 30.07.2025, me aktvendimin nr. 18-12088/2 të datës 17.9.2025, përcaktoi **NORMATIVAT DHE STANDARDET për hapësirat shkollore, pajisjet dhe mjetet mësimore për shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.***

HYRJE

Realizimi me sukses i arsimit fillor nëntëvjeçar të detyrueshëm varet nga disa faktorë, programe mësimore të hartuara me cilësi, personel mësimor i mirëtrajnuar dhe kushte hapësinore përkatëse, të cilat përfshijnë pajisjet dhe mjetet e nevojshme mësimore.

Ky dokument konfirmon normativat dhe standardet e nevojshme për hapësirën, pajisjet dhe mjetet mësimore, të nevojshme për zbatimin me sukses dhe pa ndërprerje të procesit edukativo-arsimor në shkollat fillore në vendin tonë. Aplikimi i këtyre normave dhe standardeve kontribuon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, arritjen e qëllimeve të përcaktuara, barazimin e kushteve të punës në të gjitha shkollat fillore në nivel shtetëror dhe motivimin e shkollave që të investojnë në sigurimin e pajisjeve, mjeteve mësimore dhe materialeve të përshtatshme.

Me normativat dhe standardet për hapësirat, pajisjet, mobiljet, mjetet dhe pajisjet ndihmëse mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar konfirmojnë (standardizojnë) kushtet hapësinore dhe materialo-teknike, në përputhje me kërkesat e programit mësimor, qëllimet dhe përmbajtjet e programeve mësimore. Po ashtu, përmes këtyre normave dhe standardeve përcaktohen në mënyrë integrale kushtet për zbatimin e mësimdhënies në secilën nga tri periudhat arsimore, si dhe nevojat e ndërlikuara të procesit mësimor në arsimin fillor nëntëvjeçar në tërësi.

Dokumenti "Normativat dhe standardet për hapësirën, pajisjet dhe mjetet mësimore për shkollat fillore nëntëvjeçare në Republikën e Maqedonisë së Veriut" është hartuar me qëllim që t'i përmbushë standardet dhe normat bashkëkohore për hapësirën dhe pajisjet në shkollat fillore nëntëvjeçare. Dokumentet programore janë hartuar sipas standardeve të cilat, ndër të tjera, mbulojnë edhe fushën e mjeteve mësimore dhe mjeteve ndihmëse. Megjithatë, mbulimi i mjeteve mësimore dhe mjeteve ndihmëse në dokumentet e programit është i përgjithshëm, me ç'rast imponohet nevoja për përgatitjen e dokumentit të veçantë në të cilin mbulohen mjetet mësimore, mjetet ndihmëse dhe materialet mësimore në nivel të shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Standardet dhe normat e konfirmuara në këtë dokument krahasohen me qasjet moderne didaktike, sistemet arsimore të vendeve evropiane, si dhe me normat aktuale të ndërtimit dhe arkitekturës për ndërtimin e objekteve shkollore. Në dokument janë përcaktuar të gjitha parakushtet e nevojshme për zbatimin e procesit edukativo-arsimor cilësor, duke marrë parasysh lëndët mësimore dhe specifikat e tyre në aspektin e kushteve hapësinore, pajisjeve dhe mjeteve mësimore. Këto standarde janë në përputhje me kontekstin bashkëkohor të jetës, i cili veçohet për nga progresi i shpejtë teknologjik dhe pritjet në rritje për sigurimin e një mjedisi shkollor stimulues dhe të sigurt, si dhe kushtet për një jetë të shëndetshme dhe cilësore për nxënësit. Me sigurimin e hapësirës përkatëse, pajisjeve, mjeteve mësimore dhe teknologjisë informativo-komunikative (TIK) moderne, krijohen parakushtet që nxënësit të realizojnë pa ndërprerje, në mënyrë cilësore dhe në tërësi qëllimet e kërkuara në programet mësimore në arsimin fillor.

Hapësira në shkollën fillore përbëhet nga objekti ose objektet, përkatësisht njësitë ndërtimore dhe

ato funksionale dhe hapësirat e lira jashtë ndërtesës në parcelën bashkangjitur me oborr, sallën e edukimit fizik dhe hapësirat e tjera shoqëruese. Pajisjet e shkollës përbëhen nga mobilie të përshtatshme dhe elemente të tjerë të nevojshme për punën edukativo-arsimore të shkollës.

Mjetet mësimore janë mjetet ndihmëse themelore didaktike për realizimin e punës edukative. Hapësira dhe pajisjet në shkollat fillore duhet të jenë funksionale, rationale dhe ekonomike, të qasshme dhe të kontribuojnë në krijimin e atmosferës pozitive për të mësuar. Përveç kësaj, hapësira, pajisjet dhe mjetet mësimore janë në funksion të procesit arsimor dhe duhet të ofrojnë kushte të sigurta që i plotësojnë standardet shëndetësore dhe higjienike, në përputhje me legjislacionin në fuqi nga kjo fushë.

Normativat dhe standardet për hapësirën, pajisjet dhe mjetet mësimore për shkollat fillore nëntëvjeçare në Republikën e Maqedonisë së Veriut vlejnë edhe për arsimin inkluziv, në përputhje me nenin 11 të Ligjit të Arsimit Fillor dhe përshtaten në mënyrë të arsyeshme sipas nevojave individuale të secilit nxënës.

1. STANDARDET E PËRGJITHSHME PËR SHKOLLAT

Sipas nenit 157, paragrafi 3, të Ligjit të Arsimit Fillor, komuna shpërndan mjetet për financimin e veprimtarisë së arsimit fillor, të cilat sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shkollat fillore në zonën e saj, në përputhje me normat dhe standardet e vërtetuara për hapësirat shkollore, pajisjet dhe mjetet mësimore për shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

1.1 Llojet e shkollave fillore sipas nivelit të zhvillimit

- Sipas numrit të nxënësve që mësojnë në shkollat fillore, çdo vit në fillim të vitit shkollor konfirmohet niveli i zhvillimit të shkollës fillore. Niveli i zhvillimit i shkollës përcakton gjithashtu bazën për përcaktimin e numrit të paraleleve në atë shkollë. Prandaj, sipas numrit të nxënësve, çdo vit shkollor, çdo shkollë fillore vendoset në një nga katër nivelet e zhvillimit:
- **SHKOLLË FILLORE E NIVELIT TË PARË TË ZHVILLIMIT** është ajo shkollë me më shumë se 900 nxënës (duke përfshirë nxënësit që ndjekin mësimin në shkollat periferike).
- **SHKOLLË FILLORE E NIVELIT TË DYTË TË ZHVILLIMIT** është ajo shkollë me më së paku 361 nxënës dhe më së shumti 900 nxënës (duke përfshirë nxënësit që ndjekin mësimin në shkollat periferike).
- **SHKOLLË FILLORE E NIVELIT TË TRETË** është ajo shkollë me më së paku 271 nxënës dhe më së shumti 360 nxënës (duke përfshirë nxënësit që ndjekin mësimin në shkollat periferike).
- **SHKOLLË FILLORE E NIVELIT TË KATËRT** është ajo shkollë me më së shumti 270 nxënës (duke përfshirë nxënësit që ndjekin mësimin në shkollat periferike). Nëse në komuna ka shkollë fillore të nivelit të katërt, ndërsa dendësia e popullsisë në komunë nuk tejkalon gjysmën e mesatares nacionale, atëherë ajo shkollë është "**Shkollë e mbrojtur**".

1.2 Normat për numrin e nxënësve në paralele sipas nivelit të zhvillimit të shkollave

Sipas nenit 53 të Ligjit të Arsimit Fillor, mësimdhënia në shkollat fillore zhvillohet në klasa dhe paralele, ndërsa numri i nxënësve në paralele është nga 20 deri në 30 nxënës. Si përjashtim, paralelja formohet me më pak se 20 nxënës, me pëlqimin paraprak nga themeluesi dhe me mendim pozitiv paraprak nga Ministria, ndërsa shkollat drejtohen sipas standardeve në këtë kapitull, varësisht nga niveli i zhvillimit të shkollës në vitin shkollor aktual.

NIVELI I PARË I ZHVILLIMIT

Shkollat fillore kanë paralele me të paktën 25 nxënës.

NIVELI I DYTË I ZHVILLIMIT

Shkollat fillore kanë paralele me të paktën 20 nxënës.

NIVELI I TRETË I ZHVILLIMIT

- Në komunat ku dendësia e popullsisë është nën mesataren nacionale, paralelet kanë të paktën 16 nxënës, bazuar në pëlqimin e marrë paraprakisht nga themeluesi dhe mendim pozitiv nga Ministria, në përputhje me nenin 53, paragrafi 4, i Ligjit të Arsimit Fillor.
- Në komunat ku dendësia e popullsisë është mbi mesataren nacionale, paralelet numërojnë të paktën 20 nxënës.

NIVELI I KATËRT E ZHVILLIMIT

- “Shkolla e mbrojtur” ka edhe paralele me më pak se 10 nxënës, bazuar në pëlqimin e marrë paraprakisht nga themeluesi dhe mendim pozitiv nga Ministria, në përputhje me nenin 53, paragrafi 4, i Ligjit të Arsimit Fillor.
- Në komunat ku dendësia e popullsisë tejkalon gjysmën e mesatares nacionale, por nuk është më e lartë se mesatarja nacionale, paralelet kanë të paktën 12 nxënës, bazuar në pëlqimin e marrë paraprakisht nga themeluesi dhe mendim pozitiv nga Ministria, në përputhje me nenin 53, paragrafi 4, i Ligjit të Arsimit Fillor.
- Në komunat ku dendësia e popullsisë është mbi mesataren nacionale, paralelet kanë të paktën 15 nxënës, bazuar në pëlqimin e marrë paraprakisht nga themeluesi dhe mendim pozitiv nga Ministria, në përputhje me nenin 53, paragrafi 4, i Ligjit të Arsimit Fillor.

1.3 Normat për numrin e klasave në objektin shkollor sipas nivelit të zhvillimit të shkollës

Tabela 1. Shpërndarja e numrit të klasave sipas tipizimit të shkollës

Niveli i zhvillimit të shkollës	Lloji i objektit shkollor
Niveli i parë i zhvillimit	Shkollë me 46 - 72 klasa
Niveli i dytë i zhvillimit	Shkollë me 19 - 44 klasa
Niveli i tretë i zhvillimit	Shkollë me 15 - 18 klasa
Niveli i katërt i zhvillimit	Shkollë me 9 - 14 klasa

1.4 Standardet minimale për themelimin e shkollës fillore

Tabela 2 përfshin 19 standarde për themelimin e shkollës fillore dhe përcakton parametrat me vlerat e tyre numerike.

Tabela 2¹. Karakteristikat e shkollës optimale dhe vlerat e tyre

Përshkrimi i standardit	vlera
Numri i paraleleve (2 paralele për secilën klasë)	18
Numri i paraleleve në mësimin klasor	10
Numri i paraleleve në mësimin lëndor	8
Numri i nxënësve (20 nxënës për paralele)	360
Sipërfaqja neto e shkollës (4.6 m ² për nxënës)	1,656
Sipërfaqja neto e oborrit (15 m ² për nxënës)	5,400
Numri i arsimtarëve në mësimin klasor (1.3 mësimdhënës për paralele)	13

¹Si përjashtim, shkolla fillore themelohet edhe kur nuk ka numër të mjaftueshëm nxënësish për të formuar 27 paralele, nëse themeluesi siguron mjete financiare të mjaftueshme për funksionimin e saj.

Numri i mësimdhënësve në mësimin lëndor (1.91 mësimdhënës për klasë)	16 ²
Numri i kuadrit udhëheqës (drejtor)	1
Numri i nëpunësve administrativë (sekretar, kontabilist, arkëtar etj.)	3
Numri i bashkëpunëtorëve profesionalë (pedagog, psikolog, edukator special, sociolog etj.)	2
Numri i kuadrit ndihmës-teknik (1 punonjës për 400 m ² sipërfaqe ndërtesë dhe 2.000 m ² oborr)	6
Numri i klasave universale	15
Numri i klasave speciale	3
Salla sportive/salla e fiskulturës	1
Hapësira e qëndrimit të zgjatur – gjithëditor	1
Dhoma e resurseve ³	1
Hapësira për takimet dhe këshillimet e nxënësve dhe prindërve	1

Shkollat që kanë më shumë se 35 klasa standarde në rrjetin e tyre shkollor kanë kuadër udhëheqës shtesë (ndihmësdrejtore) dhe një vend shtesë për kuadrin profesional.

Sipas numrit të përgjithshëm të nxënësve në një shkollë, numri më i madh i shkollave ka mesatarisht rreth 540 nxënës, ndërsa sipas planit mësimor, organizimi më efikas i procesit mësimor për atë numër nxënësish është 3 paralele për klasë, përkatësisht gjithsej 27 klasa – e ashtuquajtura “shkollë optimale”. Karakteristikat e shkollës optimale janë renditur në Tabelën 2a.

Tabela 2a. Karakteristikat e shkollës optimale dhe vlerat e tyre

Përshkrimi i standardit	vlera
Numri i paraleleve (3 klasa për çdo vit shkollor)	27
Numri i paraleleve në mësimin klasor	15
Numri i paraleleve në mësimin lëndor	12
Numri i nxënësve (20 nxënës për paralele)	540
Sipërfaqja neto e shkollës (4.6 m ² për nxënës - sipas normativës)	2,484
Sipërfaqja neto e oborrit (15 m ² për nxënës - sipas normativës)	8,100
Numri i arsimtarëve në mësimin klasor (1.3 mësimdhënës për paralele)	20
Numri i mësimdhënësve në mësimin lëndor (1.91 mësimdhënës për paralele)	23
Numri i kuadrit udhëheqës (drejtor)	1
Numri i nëpunësve administrativë (sekretar, kontabilist, arkëtar etj.)	3
Numri i bashkëpunëtorëve profesionalë (pedagog, psikolog, edukator dhe rehabilitues special)	2
Numri i kuadrit teknik (1 punonjës për 400 m ² sipërfaqe ndërtesë dhe 2.000 m ² oborr)	10
Numri i nxënësve të cilëve u është siguruar transporti (15% e nxënësve, sipas të dhënave historike)	81
Numri i nxënësve nga klasat I deri në III	180
Numri i nxënësve nga klasat IV deri në IX	360

2. STANDARDET E OBJEKTEVE SHKOLLORE

² Numri i mësimdhënësve rumbullakoset në numrin më të lartë.

³ Vetëm për shkollat që kanë nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Nëse në komunë ka fëmijë me aftësi të kufizuara që ndjekin pjesë të mësimin sipas një programi të modifikuar, ndërsa në një shkollë tjetër, në të njëjtën komunë nuk është krijuar qendra për mbështetje, atëherë në kuadër të shkollës parashihet edhe hapësirë për qendrën për mbështetje.

Standardizimi i objekteve shkollore ndjek tipizimin e shkollave të përmendura në kapitullin 1.

2.1 Vendndodhja e shkollave fillore

Vendndodhja përcakton zonën në të cilën planifikohet ndërtimi, rikonstruksioni dhe përmirësimi i ndërtesës së shkollës fillore, siç është planifikuar me rrjetin e shkollave fillore dhe në përputhje me planifikimin urban dhe hapësinor. Hapësira e nevojshme e shkollës fillore përcaktohet në varësi të kapacitetit të planifikuar të shkollës.

Planifikimi urbanistik i numrit, vendndodhjes dhe projektimi arkitektonik i ndërtesës shkollore përlogaritet sipas punës me një ndërrim të vetëm të shkollës në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Arsimit dhe Konceptin e Arsimit Fillor.

Vendndodhja për ndërtimin e shkollës fillore duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Zonat e dedikuara për arsimin dhe shkencën ndodhen pranë grupeve të banimit ose në pjesët periferike të zonave të gjelbra të caktuara, por drejt zonave për këmbësorë të zonave të caktuara të banimit. Rrezja e distancës për zonat e dedikuara për arsimin është 500 - 800 m nga zonat e banimit.
- Zonat e dedikuara për arsimin dhe shkencën nuk ndodhen pranë rrugëve kryesore, përkatësisht në atë rast kërkohet një distancë minimale prej 300 m nga rruga kryesore. Nëse objekti ekzistues i shkollës nuk i plotëson këto kushte, sigurohet izolim fizik dhe akustik i oborrit dhe objektit të shkollës.
- Zona e dedikuar për arsimin dhe shkencën është planifikuar në zonë të qetë, larg zonave të dedikuara industriale.
- Në mjediset urbane me njësi banimi të dendura, zonat e dedikuara për arsim dhe shkencë planifikohen në distancë maksimale nga vendbanimi në shkollë prej 500-800 m.
- Duhet të ketë rrugë të sigurt për nxënësit në relacionin vendbanim – shkollë, me gjatësi rruge që nuk i tejkalon 2 km; distanca e rekomanduar për nxënësit e shkollës klasore është deri në 600 m.
- Të jetë mjaftueshëm larg nga objektet në mënyrë që të mos bjerë nën hijen e objekteve të tjera (të paktën dy lartësi larg objektit më të lartë).
- Të ketë pajisje infrastrukturore komunale, energjetike dhe telekomunikuese (rrugë të qasshme për këmbësorët, biçikletat dhe makinat, furnizim me ujë të pijshëm, largim të ujërave të zeza, lidhje me energjinë elektrike, lidhje me rrjetin e gazit dhe/ose lidhje me ngrohjen nëse ka, lidhje me rrjetin e telekomunikacionit etj.), në përputhje me rregulloret ekzistuese.
- Në kuadër të objektit dhe oborrit të shkollës nuk duhet të ketë objekte të ushqimit të shpejtë, as makina automatike shitjeje për pije të gazuara, prodhime të konfeksionuara dhe mesafte.
- Për shkollat fillore që janë të vendosura në zonat qendrore ose objektet e kategorizuara si monumente kulture ose të vendosura në entitete kulturore dhe historike (në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore), Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA) në bashkëpunim me IITSI-në kryen vlerësimin e risqeve për zbatimin e mësimin në rast të përjashtimeve nga standardet.

- Përrjashtime nga këto norma bëjnë shkollat fillore që janë pjesë e trashëgimisë kulturore, ose objektet e vjetra që nuk kanë vlerë kulturore, por janë në përdorim dhe ato përdoren për mësim, si dhe objektet që ndodhen në bërthama kulturore.

2.2 Ndërtesa e shkollës dhe hapësirat e saj

2.2.1 Hapësirat e mësimi

2.2.1.1 Klasa universale

Klasa universale është me sipërfaqe minimale 54 m² (6 m gjerësi x 9 m gjatësi⁴) për një hapësirë maksimale shfrytëzimi prej 30 nxënësish, pra 1,8 m² për nxënë. Organizimi i klasës përshtatet sipas nevojave të shkollës, bazuar në tipizimin e shkollave fillore.

Lartësia e klasës është të paktën 3.2 m, me të paktën 5 m³ hapësirë të siguar për secilin nxënë.

Në klasën universale mbahet mësim për të gjithë nxënësit nga klasat 1 deri në 9, ose për nxënësit e moshës nga 6 deri në 14 vjeç. Klasa shërben për: të nxënit, socializimin, lojërat, pushimin dhe organizimin e punëtorive për nxënësit.

Në lidhje me vendndodhjen, klasat janë të grupuara në një pjesë të ndërtesës së shkollës dhe janë në afërsi të hyrjes. Klasa është më së shumti 35 m larg nga hyrja më e afërt e shkollës ose dalja më e afërt e evakuimit. Për objektet me gjatësi më të madhe se 35 m, projektohen dy dalje përmes korridorit ose dy shkallë në distancë jo më të madhe se 25 m, në përputhje me Rregulloren e mbrojtjes nga zjarri, shpërthimet dhe materialet e rrezikshme⁵.

Klasat universale dhe speciale, si dhe të gjitha hapësirat e tjera ku qëndrojnë nxënësit, nuk janë të projektuara nën tokë ose në pjesët e bodrumeve të objektit.

Klasat për periudhën e parë arsimore të arsimit fillor nëntëvjeçar (klasat I deri në III) dhe klasat e specializuara ndryshojnë nga klasa universale vetëm për sa u përket pajisjeve dhe organizimit të hapësirave.


Klasat e specializuara për zhvillimin e mësimi në shkencat natyrore, muzikë dhe edukimin artistik janë elaboruar në pjesën e mëtejshme.

Në të gjitha hapësirat ku qëndrojnë nxënësit, klasat universale, klasat e specializuara dhe kabinetet, sigurohet lagështia e ajrit prej 45 - 55%.

⁴ 9 m është distanca maksimale e lejuar nga rreshti i fundit i nxënësve deri te tabela, në mënyrë që të gjithë nxënësit të kenë një fushëpamje të mirë.

⁵ "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.231 e datës 25.9.2020.

Figura 1. Skicë e një klase standarde: (a) propozim për mësim frontal me dy nxënës për bankë; (b) propozim për mësim në grupe të vogla; (c) propozim për zhvillimin e punëtorive; (ç) propozim për mësim frontal me një nxënë për bankë; (d) propozim për mësim në grupe të vogla me një nxënë për bankë; (dh) propozim për zhvillimin e punëtorive me një nxënë për bankë



2.2.1.3 Klasat e specializuara

Klasë e specializuar është një hapësirë e pajisur posaçërisht në shkollë, në të cilën zhvillohet mësimi në lëndë të caktuar ose kombinimi i dy lëndëve të ngjashme, në përputhje me nevojat e planifikuara për përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve mësimore nga grupi i lëndëve të ngjashme. Numri i klasave të specializuara dhe qëllimi i tyre varet nga niveli i zhvillimit të shkollës dhe planifikohen në përputhje me numrin e klasave të parashikuara me Konceptin e Arsimit Fillor. Me qëllim që të krijohen gradualisht kushtet për funksionimin me një ndërrim të shkollave, është e nevojshme që secila shkollë të ketë të paktën dy klasa të specializuara. Klasat e specializuara përdoren për lëndët e ngjashme, përkatësisht:

- Gjuhët (gjuha amtare, gjuhë e huaj), historia dhe shoqëria
- Arsimi teknik dhe informatika

- Shkencat natyrore (biologji, fizikë, kimi)
- Edukimi muzikor dhe edukimi artistik

Për klasat e specializuara për shkencat natyrore, muzikën dhe artin, sipërfaqja duhet të jetë 3 –3.5 m²/nxënës, por jo më pak se 65 m². Çdo klasë e specializuar ka kabinetin e mësimdhënësit jo më shumë se 20 m² shtesë, por jo më pak se 10 m². Lartësia e klasës së specializuar është nga 3.2 m deri në 3.5 m.

Zyra e mësimdhënësit përdoret për përgatitjen e mësimit, për punë individuale me nxënësit, për ruajtjen e mjeteve mësimore, materialeve edukative, pajisjeve dhe mjeteve të tjera mësimore ndihmëse të nevojshme për mësimdhënien e një lënde të caktuar ose të një grupi lëndësh të ngjashme. Në këtë hapësirë pune janë sistemuar objekte që nxënësit i hulumtojnë dhe i ndjekin (bimë, kafshë), mjete ndihmëse vizuale konstruktimi i të cilave është përmes montimit dhe çmontimit, pra më i komplikuar. Kjo hapësirë përdoret gjithashtu për punën e një grupi nxënësish që tregojnë një interes të veçantë për një lëndë të caktuar ose një grup lëndësh të ngjashme.

2.2.1.4 Hapësira/t për qëndrimin e zgjatur

Hapësirat shkollore për qëndrimin e zgjatur – qëndrim gjithëditor i nxënësve në shkollë përdoret për: mësim, punë të pavarur dhe punë në grup të nxënësve, kryerjen e detyrave të shtëpisë, pushim dhe rekreacion.

Për nxënësit nga klasat I deri në III, për të cilët organizohet qëndrim i zgjatur nga e njëjta paralele, e njëjta klasë, të cilët qëndrojnë në të njëjtën klasë deri në fund të ditës.

Nëse organizohet qëndrim i zgjatur në të cilin përfshihen nxënës nga paralele dhe klasa të ndryshme, secili grup nxënësish, përveç klasës së përgjithshme, përdor dhe një hapësirë për qëndrim gjithëditor.

Madhësia e hapësirës për qëndrimin e zgjatur nuk duhet të jetë më e vogël se 54 m². Numri i hapësirave varet nga numri i grupeve të planifikuara të qëndrimit të zgjatur. Nëse është e mundur, këto hapësira duhet të sigurohen në një krah të veçantë të ndërtesës, të ndara nga hapësirat e mësimit.

Nëse shkolla punon me një ndërrim ose nuk ka kapacitete hapësinore për të caktuar një hapësirë të veçantë për qëndrimin e zgjatur, ndërsa gjatë periudhës së parashikuar për realizimin e qëndrimit të zgjatur ka klasa universale të lira, atëherë qëndrimi i zgjatur rekomandohet të realizohet në klasat universale të lira. Klasa universale gjatë qëndrimit të zgjatur është e organizuar në atë mënyrë që të ketë pjesën e punës dhe pjesën e pushimit dhe argëtimit të fëmijëve.

Në çdo shkollë ka hapësirë të veçantë për fëmijët që udhëtojnë për në shkollë, ku ata kalojnë kohën nga mbërritja në objekt deri në fillimin e mësimit dhe kohën nga mbarimi i mësimit deri në mbërritjen e transportit për në shtëpi.

2.2.1.5 Dhoma e resurseve

Dhoma e resurseve është destinuar për t'u lehtësur procesin edukativo-arsimor nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat fillore. Dhoma e resurseve është e pajisur me mobilie që u mundësojnë nxënësve të ulen ose të shtrihen, të relaksohen, të pushojnë, të qetësohen dhe të çlodhen. Hapësira është e pajisur me sensorë ndriçimi, materiale didaktike, përkatësisht lodra, kuba dhe pazëlla, tablet, televizor, pasqyrë⁶ dhe rekuizita të tjera të veçanta. Dhoma e resurseve ka kapacitete për një maksimum prej 5 nxënësish, përkatësisht duhet të ketë sipërfaqe prej të paktën 3.6 m² për nxënës. Nëse në komunë ka fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët një pjesë të mësimeve e ndjekin sipas programit të modifikuar dhe në ndonjë shkollë tjetër të së njëjtës komunë nuk ekziston ndonjë Qendër

për mbështetje, atëherë në kuadër të shkollës parashikohet edhe një hapësirë për Qendrën për mbështetje.

Qendra për mbështetje është e destinuar për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat fillore të cilat realizojnë një pjesë të programit të modifikuar. Qendra për mbështetje është e pajisur me tavolina dhe karrige, materiale didaktike dhe teknologji ndihmëse të përshtatshme për realizimin e programit të modifikuar sipas të cilit punon nxënësi me aftësi të kufizuara. Qendra po ashtu përmban dhe lodra shtesë si kuba, pazëlla dhe resurse të tjera të nevojshme për realizimin me sukses të programit. Qendra ka kapacitet deri në 10 nxënës, përkatësisht ka sipërfaqe prej të paktën 3.6 m² për nxënës.

2.2.2 Salla sportive/Salla e fiskulturës

Për nevojat e orëve të edukimit fizik dhe shëndetësor, madhësia e sallës përshtatet me nevojat e shkollës dhe tipizimin e shkollës.

Salla përmban të paktën hapësirat e mëposhtme: sallë sportive të ndërtuar sipas standardeve të përshkruara, dhoma zhveshjeje (meshkuj dhe femra) me banja të ndara për meshkuj dhe femra (me dush), hapësirë për pajisje dhe furnizime sportive dhe një hapësirë pune për mësimdhënësin e lëndës (me dush të veçantë) – kabinet sportiv. Në sallën funksionale ka gjithashtu edhe hapësirë për ofrimin e ndihmës së parë për nxënësit.

Në varësi të tipizimit të shkollës definohet edhe madhësia e sallës, si më poshtë:

- Për shkollat e nivelit të parë dhe të dytë të zhvillimit, salla ka përmasa 44.70m x 28.80m dhe lartësi 8.35m.
- Për shkollat e nivelit të tretë dhe të katërt të zhvillimit, salla ka përmasa 30.55m x 21.67m dhe lartësi 7.6m.

2.2.3 Hapësirat e klasave

2.2.3.1 Zyra e mësimdhënësve

Zyra e mësimdhënësve është hapësira e punës e mësimdhënësve. Ajo shërben si vend për të qëndruar mësimdhënësit, për punë individuale, për mbajtjen e këshillave të mësimdhënësve dhe të njësive, dhe nëse është e nevojshme, për punën e kuadrit profesional. Zyra përdoret për të organizuar ligjërata profesionale, trajnime, punëtori dhe aktivitete të tjera të organizuara që lidhen me procesin arsimor. Zyra e mësimdhënësve po ashtu përdoret për të mbajtur mbledhjet e Këshillit të Prindërve në shkollë.

Madhësia e zyrës së mësimdhënësve është minimumi 2 m² për mësimdhënësin.

2.2.3.2 Hapësira e përbashkët për mjetet mësimore sipas lëndëve

⁶ Madhësia e pasqyrës është sa madhësia e një siluete të rrituri në këmbë me krahë të hapur.

Hapësira është e paraparë për ruajtjen dhe magazinimin e mjeteve mësimore dhe mjeteve mësimore ndihmëse për nevojat e zhvillimit të mësimi. Nëse në shkollë janë siguruar kabinetet e mësimdhënësve dhe/ose hapësira të veçantë në sallën funksionale për ruajtjen e materialeve, atëherë nuk është e nevojshme të sigurohet kjo hapësirë në shkollë.

2.2.4 Hapësirat administrativo-teknike

2.2.4.1 Hapësira e udhëheqësisë së shkollës

Zyra e drejtorit dhe e ndihmësdrejtorit është nga 14 deri në 36 m². Në varësi të tipizimit të shkollës, hapësira për kuadrin udhëheqës është si vijon:

- Për shkollat e nivelit të parë të zhvillimit, hapësira ka një madhësi maksimale prej 36 m².
- Për shkollat e nivelit të dytë të zhvillimit, hapësira ka një madhësi maksimale prej 28 m².
- Për shkollat e nivelit të tretë, hapësira ka një madhësi maksimale prej 21 m².
- Për shkollat e nivelit të katërt, hapësira është 14 m².

2.2.4.2 Hapësira e administratës

Hapësira për kuadrin administrativ (sekretari, kontabilisti, arkëtari) ka sipërfaqe prej të paktën 10 m². Numri i hapësirave varet nga numri i nëpunësve administrativë të parashikuar me karakteristikat e shkollave optimale dhe vlerat e tyre.

2.2.4.3 Hapësirat e shërbimit profesional

Hapësirat e punës për shërbimin profesional (pedagogu, psikologu, edukatori dhe rehabilituesi special, sociologu, punonjësi social etj.) janë të organizuara në mënyrë që në një hapësirë të punojnë dy nëpunës të shërbimit profesional. Po ashtu, pajisjet duhet të plotësojnë nevojat e punës së të dy bashkëpunëtorëve profesionalë. Hapësirat e punës për shërbimin profesional kanë një sipërfaqe prej të paktën 15 m². Përveç hapësirave të punës për shërbimin profesional, është e nevojshme të caktohet një hapësirë për këshillimin me prindërit dhe nxënësit. Hapësira e këshillimit ka sipërfaqe prej të paktën 16 m². Hapësirat e punës dhe hapësirat e këshillimit kanë qëllimet dhe pajisjet e mëposhtme:

a) Hapësirë pune për pedagogun dhe psikologun – e pajisur me pajisjet e nevojshme (tavolinë pune, karrige etj.) që përmbushin nevojat e punës së dy bashkëpunëtorëve profesionalë.

b) Hapësirë pune për edukatorin dhe rehabilituesin special dhe/ose ndonjë bashkëpunëtor tjetër profesional – e pajisur me pajisjet e nevojshme (tavolinë pune, karrige etj.) që përmbush nevojat e të dy bashkëpunëtorëve profesionalë.

c) Hapësira për këshillimin e prindërve dhe nxënësve përdoret për: punë individuale dhe këshillimin e nxënësve; punë individuale me prindërit; konsultime me mësimdhënësit; punë në grupe me mësimdhënësit, prindërit, mësimdhënësit; realizimin e punës edukativo-arsimorë korrektuese speciale me nxënësit që kanë pengesa të lehta në zhvillimin fizik dhe mendor dhe që nuk realizohet së bashku me nxënësit e tjerë të paraleles. Hapësira siguron anonimitetin dhe konfidencialitetin për nxënësit dhe prindërit gjatë procesit të këshillimit. Për format e tjera të punës, pedagogu dhe psikologu përdorin edhe hapësirën shumëfunksionale në shkollë.

2.2.4.4 Hapësira për takimet me prindërit

Në ndërtesën e shkollës është parashikuar hapësirë për takimet me prindërit. Ajo është hapësira në të cilën mbahen takime të organizuara të udhëheqësit të klasës ose të mësimeve të klasës me prindërit, me qëllim informimin e ndërsjellë në lidhje me punën e nxënësve në shkollë dhe në shtëpi, përparimin e tij në të mësuar, tiparet e karakterit të nxënësve, marrëdhënien e tij me shokët dhe mësimeve etj., ose për organizimin e aksioneve të përbashkëta të prindërve dhe mësimeve në lidhje me jetën, punën dhe suksesin e nxënësve.

Hapësira e takimeve me prindërit e nxënësve të regjistruar në shkollën fillore, si rregull, është me sipërfaqe prej 6 deri në 10 m² dhe ndodhet pranë hyrjes së ndërtesës.

2.2.4.5 Hapësira e kuadrit ndihmës

Hapësira e kuadrit ndihmës është hapësirë e veçantë ose në kuadër të hapësirës për magazinimin dhe ruajtjen e pajisjeve dhe mjeteve të pastrimit dhe mirëmbajtjes. Është e nevojshme të ketë të paktën 1 m² për secilin kuadër teknik të punësuar (sipas karakteristikave të shkollave optimale dhe vlerave të tyre).

Nëse hapësira për kuadrin ndihmës është e përbashkët me hapësirën për ruajtjen e pajisjeve dhe mjeteve të pastrimit dhe mirëmbajtjes, atëherë ajo duhet të jetë të paktën 1.5 m² për të punësuar (sipas karakteristikave të shkollave optimale dhe vlerave të tyre)

2.2.4.6 Magazinimi i ushqimeve

Magazina e ushqimeve është hapësirë e pavarur ose në kuadër të kuzhinës së shkollës me hyrje të veçantë për furnizimin e ushqimeve. Magazina e ushqimeve shërben për ruajtjen e artikujve ushqimorë që përdoren për përgatitjen ose ndarjen e mesafteve (snekeve) ose vakteve në shkollë. Madhësia e magazinës varet nga madhësia e shkollës sipas tipizimit, numrit të nxënësve që shërbehen me mesafte (sneke) ose me vakte gjatë kohës që janë në shkollë dhe madhësisë së kuzhinës. Magazina e ushqimeve është mes 5-20 m².

2.2.4.7 Hapësira e mirëmbajtjes teknike të ndërtesës

Hapësira e mirëmbajtjes teknike të ndërtesës është hapësirë e veçantë ose është pjesë përbërëse e hapësirës së kuadrit ndihmës. Kjo hapësirë shërben për ruajtjen dhe magazinimin e të gjitha pajisjeve dhe mjeteve tekniko-higjienike që shërbejnë për mirëmbajtjen e ndërtesës. Hapësira ka të paktën 0.5 m² për anëtar të kuadrit teknik.

2.2.4.8 Hapësira e sistemit të ngrohjes

Në hapësirën e ngrohjes përllogaritet sistemi i ngrohjes së ndërtesës shkollore dhe më shpesh ndodhet në bodrumin e objektit. Në varësi të teknologjisë dhe burimit të energjisë së përdorur, hapësira është objekt i veçantë që i përmbush të gjitha rregulloret dhe standardet ekzistuese.

2.2.4.9 Dhoma e pajisjeve elektrike dhe dhoma e serverëve

Çdo shkollë ka vend të përshtatshëm ku mirëmbahet dhe mbështetet instalimi elektrik i ndërtesës. Nëse shkolla ka sistemin e vet për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e ndërtesës dhe/ose nëse ka servera fizikë për ruajtjen e të dhënave, atëherë është e nevojshme të ketë hapësirë të veçantë për ruajtjen e këtyre pajisjeve. Hapësira elektrike dhe hapësira e serverëve janë të ndara ose në një dhomë të përbashkët. Madhësia e dhomës/dhomave varet nga specifikimet teknike të kërkuara nga prodhuesi i teknologjisë së përdorur në ndërtesë.

2.2.5 Hapësira e përbashkët

2.2.5.1 Biblioteka

Biblioteka ka pjesë pranimi, pjesë për depozitimin e librave dhe pjesën e leximit. Biblioteka ka një sipërfaqe prej të paktën 2 m² për nxënës për përdorim të njëkohshëm nga 5% e nxënësve. Sipërfaqja totale e bibliotekës varet nga tipi i shkollës, si më poshtë:

- Për shkollat e nivelit të parë të zhvillimit, biblioteka është të paktën 90 m².
- Për shkollat e nivelit të dytë të zhvillimit, biblioteka është të paktën 45 m².
- Për shkollat e nivelit të tretë të zhvillimit, biblioteka është të paktën 30 m².
- Për shkollat e nivelit të katërt të zhvillimit, biblioteka është të paktën 15 m².

2.2.5.2 Salla e leximit

Salla e leximit është një hapësirë e veçantë e lidhur me bibliotekën ose e ndarë nga biblioteka. Salla e leximit është e përbërë nga pjesët për punë individuale dhe për punë në grup të nxënësve, të mësimit dhe shërbimit profesional. Hapësira ka kapacitet për të paktën 5% të numrit të përgjithshëm të nxënësve dhe madhësia mesatare për nxënës është 0.5 m², por jo më pak se 60 m². Përveç qëllimit kryesor të sallës së leximit, biblioteka e nxënësve me sallën e leximit përdoret edhe për të organizuar aktivitete jashtëshkollore siç janë: promovim i librave të rinj, takime me shkrimtarë dhe poetë, leximi i poezive dhe prozave nga autorë të shquar ose nga nxënësit etj.

2.2.5.3 Hapësira shumëfunktionale

Hapësira shumëfunktionale, siç thotë edhe vetë emri, do të përdorej për: pushimin e nxënësve, ekspozitat shkollore, ligjëratat, seminarët, shfaqjet, takimet e përbashkëta prindërore të më shumë paraleleve dhe ngjarjeve të tjera publike në shkollë. Gjatë projektimit të hapësirës shumëfunktionale, i kushtohet vëmendje lidhjes së saj funksionale me komunikimet, bibliotekën, sallën e ngrënies dhe me dhomat e tjera të përbashkëta. Si përjashtim, hapësira shumëfunktionale është projektuar edhe si pjesë e zgjeruar e korridorit të shkollës.

Madhësia e hapësirës shumëfunktionale varet nga lloji i zhvillimit të shkollës, por nuk është më pak se 0.3 m² për nxënës.

2.2.5.4 Kuzhina dhe salla e ngrënies

Kuzhina në SHF shërben për përgatitjen e vakteve të ngrohta dhe të ftohta për nxënësit. Në kuzhinë përgatitet ose shërbehet ushqimi. Pavarësisht nga lloji i kuzhinës, ajo duhet të përmbushë standardet e përcaktuara të ushqimit (standardet HACCAP) dhe kushtet higjieno-teknike për përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimit. Sistemimi i kuzhinës është funksional sipas rendit teknologjik të pranimi, përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit.

Salla e ngrënies është e lidhur me kuzhinën për shpërndarjen më të lehtë të ushqimit dhe ka sipërfaqe prej 1.2 m²/nxënës, por jo më pak se 60 m², me pajisje të përshtatshme për të gjitha grupmoshat e nxënësve. Hapësira ka mundësi ajrosjeje në mënyrë që aroma e ushqimit të gatuar në kuzhinë të mos përhapet në ambientet e tjera.

2.2.6 Hapësirat shëndetësoro-sanitare

2.2.6.1 Hapësirat sanitare

Tualetet në shkollë përcaktohen sipas numrit të nxënësve. Shpërndarja e tualeteve në ndërtesën e shkollës varet nga numri i përdoruesve (nxënësve dhe punonjësve) për kat. Tualetet janë të lidhura

me korridoret e shkollës dhe preferohet që ato të vendosen në anën veriore të ndërtesës së shkollës. Ato janë të ndara për nxënësit (vajzat dhe djemtë) dhe për punonjësit (burrat dhe gratë).

Sipas standardeve arkitektoniko-ndërtimore, hapësirat për pjesën e tualeteve janë nga 15 m² deri në 20 m² për 100 nxënës me tualete të ndara në dy pjesë⁷. Lavamanët janë detyrimisht të ndarë nga tualetet. Në afërsi imediate të hapësirave për qëndrim të zgjatur dhe gjithëditor janë planifikuar hapësira të veçanta sanitare.

Gjatë ndërtimit të shkollave të reja, është e nevojshme të planifikohen nyja sanitare të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, gjatë rikonstruksionit dhe adaptimit të ndërtesave ekzistuese shkollore, parashikohet adaptimi i nyjave sanitare për nxënësit me aftësi të kufizuara, të cilat janë në përputhje me rregulloren për standardet teknike për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e objekteve, duke garantuar kështu lëvizje dhe qasje pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara fizike.

Gjatë dimensionimit të nyjave sanitare për nxënësit, për çdo 40 nxënës parashikohen 1 WC dhe 2 urinale, dhe për çdo 20 nxënës femra parashikohen 2 WC. Si parahapësirë vjen hapësira me lavamanë si te tualetet e meshkujve ashtu edhe te femrat. Gjatë dimensionimit të pjesës së tualeteve të mësimdhënësve parashikohen 1 WC dhe 1 urinal për çdo 20 mësimdhënës, dhe parashikohet 1 WC për çdo 10 mësimdhënës femra. Parahapësira në tualetet e mësimdhënësve përmban të paktën një lavaman të përbashkët ose një lavaman të veçantë për secilën tualet të meshkujve dhe të femrave.

2.2.7 Hapësirat e komunikimit

2.2.7.1 Hyrja në shkollë

Hyrja në shkollën fillore është e qasshme nëpërmjet derës hyrëse mjaftueshëm të gjerë dhe nëpërmjet rampës për lëvizjen pa pengesa të personave me aftësi të kufizuara fizike, me një pjerrësi të lehtë që ndryshon nga 1:20 (5%) deri në 1:12 (8.33%). Qasja tek objekti është e shtruar me pllaka ose e asfaltuar dhe pa barriera arkitektonike.

Dera e hyrjes në shkollë është me dimensione për derë me një kanat prej të paktën 110 cm, për derë me dy kanate prej të paktën 180 cm. Thellësia e xhamit është të paktën 240 cm.

2.2.7.2 Portieria

Portieria ndodhet pranë hyrjes së ndërtesës së shkollës dhe është pjesë e korridorit të shkollës. Madhësia e saj është 4 m², dhe sipas normës është planifikuar për shkollë të nivelit të parë, të dytë dhe të tretë të zhvillimit.

2.2.7.3 Korridoret

Korridoret sigurojnë qasje të lehtë dhe të sigurt në çdo hapësirë të shkollave fillore, janë të dimensionuara me një gjerësi jo më pak se 1.5 m, kanë parmakë sigurie në mure, dyshemeja në korridore është detyrimisht e papërshkueshme nga zjarri, me qëllim sigurimin e evakuimit të sigurt në rast zjarri, nuk është e rrëshqitshme, me shteg prekës për nxënësit e verbër. Korridoret e kanë të detyrueshme të kenë tabela dhe shirita fluoreshente të shënuar që të çojnë në dalje. Nëse shkolla ka korridor qendror, atëherë ky korridor është dizajnuar në formë amfiteatri të vogël, i përshtatshëm për mbajtjen e ngjarjeve dhe festimeve në shkollë.

⁷ Veçmas për djemtë, veçmas për vajzat, përveç për nxënësit e periudhës së parë arsimore, kur është e lejueshme të jenë edhe të përbashkëta.

Korridoret që të çojnë në klasa janë të dimensionuar në mënyrë të tillë që kur në korridor ka dy klasa në rresht, gjerësia e korridorit është 1.5 m. Për çdo klasë shtesë në rresht, korridori rritet me 0.3 m.

Nëse në korridore janë vendosur dollapë për nxënësit, atëherë gjerësia e korridorit është më e gjerë se thellësia e dollapëve, por jo më pak se 60 cm.

Si rregull, dyert hapen nga jashtë. Dyert që hapen nga jashtë nuk duhet të pengojnë lëvizjen e nxënësve në korridor dhe hyjnë jo më shumë se 20 cm në drejtim të evakuimit.

2.2.7.4 Shkallët

Shkollat fillore në përgjithësi janë të projektuara si objekt me kat përdhes dhe 2 kate (Rregullorja për mbrojtjen nga zjarri, shpërthimi dhe substancat e rrezikshme⁸). Nëse shkolla është me kate, atëherë shkallët ndodhen pranë daljeve dhe janë të pajisura me parmakë në të dyja anët nëse shkallët janë të pavarura, ose në njërin anë nëse shkallët janë të lidhura me mur. Parmaku është i lartë 1 deri në 1.1 m. Gjerësia e shkallëve është të paktën 1.25 m, por jo më shumë se 2.5 m. Lartësia e një shkalle është më së shumti 15 cm dhe gjerësia e saj 33 cm.

2.3 Qëndrueshmëria e objektit shkollor

Projektimi dhe ndërtimi/përshtatja i qëndrueshëm i shkollave përqendrohet në rolin e objektit shkollor në mbrojtjen e mjedisit nga rreziqet në rritje të ndryshimeve klimatike. Megjithatë, ndërtesë shkollore e qëndrueshme është një ndërtesë me performancë të lartë që është projektuar për të pasur më pak ndikim në mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut dhe që përmbush kërkesat minimale të performancës energjetike dhe bashkëjeton në harmoni me natyrën.

2.3.1 Shkollat me efikasitet energjetik

Përmirësimi i efikasitetit energjetik arrihet me anë të përdorimit aktiv dhe pasiv të energjisë diellore. Shfrytëzimi aktiv i energjisë diellore në ndërtesat shkollore është i mundur duke instaluar sisteme për përfitimin e ujit të nxehtë - panele diellore dhe duke marrë energji elektrike me ndihmën e paneleve fotovoltaike. Shfrytëzimi pasiv i energjisë diellore është potencial që përdoret gjatë planifikimit të aktiviteteve ndërtimore për shkollat: përmirësimi i një objekti ekzistues, ndërtimi i një ndërtese të re ose të bashkangjitur dhe rinovimi i kapaciteteve ekzistuese.

Për ndërtesat e reja shkollore, klasa më e ulët energjetike është klasa "C". Llogaritja e mbrojtjes termike nga aspekti i regjimit veror bëhet në përputhje me standardin e harmonizuar vendor MKS EN 13363-1.

Për ndërtesat shkollore që i nënshtrohen rikonstruksionit të rëndësishëm, klasa më e ulët energjetike është klasa "D". Në rastin e rikonstruksionit të rëndësishëm të ndërtesave ekzistuese shkollore, karakteristikat energjetike të ndërtesës së rikonstruktuar, përkatësisht njësisë ndërtimore, duhet të jenë në përputhje me kërkesat minimale të efikasitetit energjetik, nëse ato janë të justifikuara teknikisht, funksionalisht dhe ekonomikisht, si dhe në përputhje me standardet e harmonizuara vendore. Në rastet kur elementet individuale, që përbëjnë pjesën e izolimit të ndërtesës dhe që kanë ndikim të rëndësishëm ndaj karakteristikave energjetike të izolimit rikonstruktohen ose zëvendësohen, këto elemente duhet të plotësojnë kërkesat minimale të efikasitetit energjetik.

⁸ "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 231 e datës 25.9.2020.

Karakteristikat energjetike të ndërtesave të institucioneve publike në fushën e arsimit dhe shkencës janë përcaktuar në "Rregulloren e karakteristikave energjetike të ndërtesave"⁹ dhe në Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian mbi karakteristikat energjetike të ndërtesave.

2.3.1.1 Arritja e komfortit klimatik

2.3.1.1.1 Arritja e komfortit klimatik në mënyrë natyrale (pasive)

Për të kontrolluar efektet klimatike në hapësirën e shkollës dhe për të siguruar përdorimin optimal të energjisë diellore pasive, që nga fillimi i planifikimit dhe projektimit, projektuesit marrin parasysh disa aspekte që lidhen me:

- I. **Orientimin e ndërtesave shkollore:** ana "kryesore" e objektit është e orientuar nga jugu (180°), me devijime maksimale të këndit prej $\pm 30^\circ$. Dritaret janë të dizajnuara për kalim selektiv të rrezatimit diellor (dimër/verë), me orientim jugor ato kanë sipërfaqe të mëdha, ndryshe nga ato me orientim nga juglindja në veriperëndim, të cilat plotësojnë vetëm kërkesat për dritën ditore.
- II. **Organizimin e ndërtesave:** distanca mes ndërtesave shkollore nga fasada në fasadë është proporcionale me lartësinë e ndërtesave për të lejuar ventilimin e ajrit të pastër dhe dritën natyrale në nivelet më të ulëta. Për të njëjtat arsye, parashikohet distancë minimale prej 4 m midis fasadave kryesore dhe murit të rrethojës.
- III. **Formën dhe dizajnin e ndërtesave shkollore:** të favorizohen shkollat njëkatëshe për të maksimizuar dritën e ditës dhe për të rritur perimetrin e sipërfaqes së bazës dhe çatisë. Në shkollat shumëkatëshe, minimizoni thellësinë (gjerësinë) e dhomave për të maksimizuar kontributin e dritës së ditës. Për të lejuar ventilimin gjatë temperaturave të larta, veçanërisht në zonat e thata të zgjidhet çati me katër pjerrësi në zonat me reshje të dendura dëbore.
- IV. **Aplikimin e duhur të strukturave dhe materialeve:** përfshin kullimin e duhur të çatisë dhe drenazhën e vendit përreth ndërtesave shkollore, hijezimin me perde/roleta të rregullueshme nëpër dritare për mbrojtjen nga dielli, strehë me mbrojtje shtesë nga rrezet e diellit dhe shiu, veçanërisht kur orientimi i ndërtesës është i pafavorshëm. Shumë i rëndësishëm është edhe izolimi i mureve, themeleve dhe çative, përkatësisht ndërtim pothuajse hermetikisht i mbyllur i objektit me sistem qarkullimi ajri natyral dhe/ose pjesërisht artificial. Për këtë qëllim, në dritare vendoset xham me izolim të dyfishtë dhe/ose të trefishtë. Përdorimi i materialeve natyrore të ndërtimit me përçueshmëri minimale të nxehtësisë përmes strukturës, për të shmangur të ashtuquajturat ura energjie dhe për të maksimizuar përdorimin e dritës së diellit dhe nxehtësisë natyrore. Përveç kësaj, përfshin mure me tone të çelëta, të cilat reflektojnë mirë dritën, ose, si alternativë, përdoren materiale izoluese për të rritur inercinë termike të mureve, siç janë blloqet e betonit.
- V. **Peizazhin hortikulturor:** vegjetacioni është thelbësor për krijimin e mikroklimës. Mbjellja e pemëve kontribuon në mënyrë efektive në mbrojtjen nga pluhuri, zhurmat, erërat dhe rrezet direkte të diellit.

⁹ "Gazeta Zyrtare" nr. 94/2013, nr. 7/2015 dhe nr. 176/15.

2.3.1.1.2 Arritja e komfortit klimatik në mënyrë artificiale (aktive)

Duke instaluar një sistem modern ngrohjeje qendrore me rregullim automatik me valvula termostatike në elementët e ngrohjes, arrihet temperatura optimale e dëshiruar në secilën dhomë veç e veç dhe arrihen kursime të konsiderueshme të energjisë.

2.3.1.2 Sisteme mekanike ngrohjeje, ventilimi dhe klimatizimi

Sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe klimatizimit (HVAC) shpesh janë përgjegjëse për 50%-60% të energjisë së konsumuar në shkolla. Sistemet HVAC gjithashtu kanë ndikim të rëndësishëm në shëndetin, komfortitetin, produktivitetin dhe performancën akademike të nxënësve dhe mësimitdhënësve. Për të përmirësuar efikasitetin energjetik, ndërtesa e shkollës është projektuar për të përmbushur kërkesat e komfortit pasiv, duke zvogëluar kështu ngarkesat e ngrohjes dhe ftohjes në sistemin HVAC.

Niveli i komfortit gjatë temperaturave më të ulëta është mes 21°C dhe 25°C. Modeli i punës së shkollave është gjithashtu faktor që ndikon në zgjedhjen e komfortit termik: java e punës në shkollë është kryesisht nga e hëna në të premte, nga ora 08:00 deri në 17:00 (ose më shumë me ndërime të dyfishta) kur është e nevojshme të ngrohet ndërtesa, ndërsa në fundjavë dhe gjatë pushimeve dyjavore dimërore, ngrohja është minimale ose nuk kërkohet fare.

Përdorimi aktiv i energjisë diellore në ndërtesat shkollore është i mundur nëpërmjet instalimit të sistemeve për përfitimin e ujit të ngrohtë – paneleve diellore dhe për përfitimin e energjisë elektrike duke përdorur panele fotovoltaike.

2.3.1.3 Përdorimi i burimeve të energjisë së ripërtëritshme

Burimet e energjisë së ripërtëritshme, siç janë energjia diellore, energjia e biomasës dhe pompat e nxehtësisë, përdoren gjithashtu për ndërtesat shkollore, qoftë veçmas ose në kombinim. Gjatë projektimit të objektit, është e nevojshme të hulumtohen kushtet për përdorimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme. Për këtë qëllim, është e nevojshme të përgatitet:

- Analiza e kushteve klimatike të vendndodhjes;
- Analiza e vendosjes dhe qëndrueshmërisë së çatisë, nëse bëhet fjalë për objekt ekzistues;
- Analiza e instalimit të sistemeve diellore termike për ujë të ngrohtë;
- Hulumtime hidrogeologjike nëse instalohen puse shfrytëzimi për përdorimin e energjisë gjeotermale.

2.3.1.3.1 Komforti vizual

2.3.1.3.2 Ndriçimi natyror

Rekomandime për përdorimin e ndriçimit natyror

- Numri, dimensionet, vendosja dhe shpërndarja e dritareve korrespondojnë me sasinë e kërkuar të dritës (dhe të rrjedhjes së ajrit). Duke marrë parasysh rëndësinë e ndriçimit natyror, sipërfaqja totale e dritareve në hapësirat e klasave është 15 deri në 20% e sipërfaqes së dyshemesë;
- Gjatë përdorjes së strehave, mbështetësve dhe/ose kangjellave për të mbrojtur dritaret, ndikimi i tyre ndaj dritës natyrale nuk pengon përmbushjen e rekomandimit nga paragrafi i mëparshëm.

Gjatë projektimit duhet të tregohet kujdes që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabarta arsimore, në mënyrë që:

- Distanca maksimale mes rreshtit të fundit të nxënësve dhe dërrasës kryesore nuk duhet të jetë më shumë se 9 m;
- Distanca minimale mes rreshtit të parë dhe dërrasës duhet të jetë 2 m;
- Këndi minimal vizual i dërrasës kryesore është 30°, në mënyrë që këndi në të cilin shihet mjete mësimor të mos prishë vizualisht të kuptuarit e asaj që shohin nxënësit;
- Drita kryesore natyrore llogaritet në anën e majtë të nxënësve.

2.3.1.3.3 Ndriçimi artificial

Ndriçimi paraqet 25%-40% të shpenzimeve të energjisë së një shkolle, ndërsa përmirësimi i efikasitetit të sistemit të përgjithshëm të ndriçimit zvogëlon nevojat energjetike, prandaj rekomandohet:

- Përdorimi i llambave efikase (llamba LED, llamba fluoeshente, llamba fluoeshente kompakte CFL me amortizues të integruar;
- Sigurimi i sensorëve të lëvizjes, çelësve digjitalë modernë (digital time switch) dhe kontrole të tjera që kufizojnë kohën e ndezur të llambës;
- Sigurimi i fotosensorëve të dritës së ditës që fikin ndriçimin elektrik kur ka dritë të mjaftueshme natyrore.

2.3.1.4 Komforti akustik

Me qëllim që të sigurohet mjedis i mirë akustik, gjatë projektimit të shkollës merren parasysh kushtet e mëposhtme:

- (I) **Vendndodhja e shkollës:** zhurma e jashtme kontrollohet duke i vendosur ndërtesat shkollore sa më larg instalimeve të zhurmshme, duke i orientuar hapësirat e klasave larg burimeve të zhurmës, duke ndërtuar mure perimetrale rreth vendit të shkollës ose duke rritur elementet e peizazhit për të kufizuar depërtimin e zhurmës së jashtme (tregje, autostrada, stacione...).
- (II) **Vendndodhja e ndërtesave në lidhje me burimet e brendshme dhe të jashtme të zhurmave,** si për shembull, fushat e lojërave, salla shumëfunktionale, klasa e muzikës dhe hapësira të tjera nga të cilat priten nivele të larta zhurme, ndodhen sa më larg të jetë e mundur nga klasat e tjera, biblioteka dhe hapësira të tjera të qeta.
- (III) **Fuqia izoluese akustike e klasave universale dhe të specializuara:** dera e brendshme e klasës ka fuqi izoluese akustike prej 32 dB. Muret e jashtme të klasave kanë fuqi izoluese akustike prej 50 dB. Meqë një pjesë e madhe e mureve të jashtme janë me dritare me xhama, ato kanë fuqi izoluese akustike prej të paktën 30 dB.
- (IV) **Izolimi i zërit:** merren masa për të siguruar izolim të mjaftueshëm të zërit midis hapësirave (klasave, sallave, zyrave...) për të parandaluar shqetësimet e shkaktuara nga zhurmat e jashtme ose të brendshme. Materiali i ngurtë, siç janë muret e betonit mes burimit të parashikueshëm të zhurmave dhe zonave ngjitur të mësimin dhe aktiviteteve zvogëlon zhurmën; dhe
- (V) **Materialët dhe teknikat përshtaten për të kontrolluar zhurmën mes hapësirave dhe hapësirave të brendshme:** përdorimi i materialeve absorbuese në tavan, ndërtimi i mureve të jashtme të dyfishta të ndara nga një zgavër e mbushur me materiale izoluese (polistiren), ndarje dhe mure me trashësi 18 cm mes hapësirave mësimore, materiale për përpunimin përfundimtar të dyshemesë që ndihmojnë në zvogëlimin e zhurmave të goditjeve, mbushja e nyjave rreth tubave dhe kanaleve të ajrit... etj.

2.3.2 Përdorimi me efikasitet i ujit

Ekzistojnë kryesisht tri lloje ujërash që trajtohen dhe/ose mblidhen nga objektet shkollore. Ato janë (I) ujërat e ndotura nga kabinat e tualeteve; (II) ujërat e ndotura nga lavamanët dhe dushet; dhe (III) ujërat e shiut nga çatitë ose nga zonat e jashtme. Për tërheqjen e ujërave të ndotura nga objektet sanitare, laboratorët, mensat etj., është e nevojshme të instalohet sistem për tërheqjen e ujërave të ndotura për të parandaluar ndikimet negative në mjedisin jetësor dhe në popullsinë lokale. Udhëzimet për projektimin e objekteve hidroteknike rregullohen me Ligjin e ndërtimit¹⁰ në aktet nënligjore që dalin prej tij.

2.3.3 Selektimi i mbetjeve

Shkollat posedojnë:

- të paktën një komplet prej tre koshash riciklimi për letra, plastikë dhe alumin prej 120 litrash në secilën klasë.
- enë për selektimin dhe kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme nga mensa dhe mbetjet organike të mbledhura në oborrin e shkollës dhe kompostimin e tyre. Komposti i përfituar të përdoret për fidanët në oborrin e shkollës.

Në oborrin e shkollës caktohet vendi për vendosjen e kontejnerëve prej 1,1m³ për selektimin e mbetjeve, të cilët më pas largohen nga një operator i licencuar.

2.3.5 Rregullimi funksional i hapësirave të jashtme

2.3.5.1 Rregullimi hortikulturor

Oborri i shkollës ka sipërfaqe të gjelbra që shërbejnë për aktivitete të përditshme dhe kryesisht për rekreacion, arsim, ngjarje kulturore, socializim, sport dhe qëllime ekonomike. Rregullimi i vendit duhet të kërkojë mirëmbajtje minimale dhe kursimin e ujit. Materiali i mbjellë siguron hije, mbrojtje nga era, kontroll të erozionit të tokës dhe përmirëson pamjen estetike të hapësirës shkollore.

Është veçanërisht e rëndësishme të përdoren lloje bimësh dekorative të përshtatura me karakteristikat klimatike të vendndodhjes së shkollës dhe të përdoren teknika moderne për kujdesin dhe mirëmbajtjen e materialit bimor, të tilla si:

- aplikimi i sistemeve të ujitjes dhe spërkatjes;
- mbrojtje e duhur e bimëve që janë të ndjeshme ndaj temperaturave të ulëta të dimrit.

Të shmangët mbjellja e fidanëve me gjemba, frutave të mëdha dhe të rënda, frutave që fermentohen shpejt, frutave helmuese, frutave që lëshojnë ngjyra, frutave që ndotin mjedisin urban (frutëzimi i plepave dhe shelgjeve). Nëse ato veçmë janë, atëherë ato duhet të mirëmbahen siç duhet dhe profesionalisht (të krasiten). Të mos përdoren lloje pemësh që shkaktojnë alergji dhe pasoja të tjera të padëshirueshme për shëndetin e nxënësve.

¹⁰ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 70/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/15, 129/15, 217/15, 226/15, 30/16, 31/16, 29/16, 71/16, 132/16, 35/18, 64/18, 168/18, 244/19 dhe 18/20 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 279/20, 227/22, 111/23, 224/24, 255/24, 3/25, 17/25 dhe 87/25.

2.3.6. Mbrojtja e shkollave nga çrregullimet e kushteve dhe nga katastrofat natyrore

Masat parandaluese në sistemin e integruar dhe të unifikuar të mbrojtjes dhe shpëtimit përcaktohen nga Ligji i Mbrojtjes dhe Shpëtimit¹¹. Përmbajtja dhe mënyra e zbatimit të trajnimit për vetëmbrojtje në institucionet arsimore përcaktohet në Rregulloren mbi përmbajtjen dhe mënyrën e zbatimit të trajnimit për vetëmbrojtje në institucionet arsimore. Sipas Ligjit të sigurisë dhe shëndetit në punë¹², çdo shkollë ka: program për mbrojtje dhe siguri personale dhe kolektive, parandalim dhe mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, zjarret, përmytjet dhe kërcënimet dhe rreziqet e ngjashme, dhe Plan evakuimi me ushtrime të planifikuara në nivel shkolle, kurse të ndihmës së shpejtë dhe mbrojtjes. Nxënësit informohen dhe trajnohen rregullisht se si të sillen në rast rreziku. Për mbrojtjen dhe sigurinë në hapësirat shkollore duhet të ketë një plan për kujdestarinë e mësimdhënësve dhe shërbimit teknik gjatë orëve të mësimi, si dhe shërbim roje sigurie.

3. Arkitektura dhe ndërtimi i shkollave

Procedura për ndërtimin e objekteve të destinuara për arsimin fillor është përcaktuar me Ligjin e ndërtimit, dhe ky dokument mbulon specifikat e ndërtimit të objekteve shkollore dhe infrastrukturës, me qëllim koordinimin e institucioneve kompetente dhe monitorimin e situatës me rrjetin shkollos në të gjitha komunat.

3.1 Projektimi i shkollave

Gjatë projektimit të shkollave i kushtohet vëmendje e veçantë vendndodhjes së ndërtesës shkollore në lidhje me anët e botës, si dhe infrastrukturën e makrolokacionit në të cilin ndodhet shkolla. Të gjitha hapësirat e lartpërmendura janë të paraqitura grafikisht në mënyrë të përshtatshme dhe të pozicionuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë shfrytëzimin maksimal të hapësirës.

Në përgjithësi klasat universale dhe të specializuara janë të orientuara nga anët që kap dielli, ndërsa kuzhina, tualetet dhe hapësirat ndihmëse janë të orientuara drejt pjesëve të ndërtesës që nuk i kap dielli.

Çdo ndërtesë shkollore ka të paktën dy hyrje, një hyrje kryesore për në shkollë dhe një hyrje dytësore, e cila përdoret për qasje të shpejtë në hapësira të caktuara pranë asaj hyrjeje dhe në rast nevojë për evakuimin e shpejtë të nxënësve. Në varësi të numrit të nxënësve dhe madhësisë së ndërtesës së shkollës rritet edhe numri i hyrjeve ndihmëse. Numri i hyrjeve përcaktohet me Rregulloren e mbrojtjes nga zjarri, shpërthimet dhe materialet e rrezikshme¹³.

Për shkollat nuk rekomandohet dalja direkte nga klasa në oborr, veçanërisht për nxënësit e klasave më të vogla, ku hyrja dhe dalja e fëmijëve kontrollohet nga mësimdhënësi.

¹¹ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 36/04, 49/04, 86/08, 114/09, 124/10, 18/11, 41/14, 129/15, 71/16, 106/16 dhe 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 215/21 dhe 124/25.

¹² “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 92/2007, 136/2011, 23/2013, 25/2013, 137/2013, 164/2013, 158/2014, 15/2015, 129/2015, 192/2015 dhe 30/2016 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 18/20 dhe 74/25.

¹³ Rregullorja e mbrojtjes nga zjarri, shpërthimet dhe materialet e rrezikshme “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 231 të datës 25.9.2020.

Gjatë projektimit të ndërtesës së shkollës implementohen sistemi i alarmit kundër zjarrit, spërkatësit ose hidrantët dhe pajisjet zjarrfikëse për shuarjen e shpejtë të zjarreve.

3.2 Ndërtimi i shkollave

Gjatë ndërtimit të një shkolle tregohet kujdes në përzgjedhjen e materialeve që do të përdoren. Është veçanërisht e rëndësishme që ndërtesa të jetë e izoluar mirë nga depërtimi i ujërave nëntokësore dhe lagështisë. Përdoren materiale të përshtatshme hidroizoluese dhe kryhet analizë e sasisë së ujërave nëntokësore për të përcaktuar mënyrën me të cilën duhet të izolohet objekti. Me rëndësi të veçantë është që shkolla të ndërtohet si objekt pa lagështi dhe i qetë, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të fëmijëve që qëndrojnë në të.

Ndërtesat shkollore ndërtohen me materiale të forta, të cilat nuk marrin flakë lehtë, janë rezistente ndaj goditjeve dhe nuk ndotin as mjedisin mjedisin jetësor dhe as ata që qëndrojnë në të. Elementet strukturore mbajtëse të objektit janë rezistentë ndaj zjarrit për të paktën 2 orë. E njëjta gjë vlen edhe për muret që pengojnë përhapjen e lirë të zjarrit¹⁴.

Muret janë të lëmuara, të punuara mirë, të mbrojtura nga lagështia dhe me ngjyra të ngrohta, të cilat kanë efekt pozitiv në humorin e fëmijëve. Muret e klasave janë me trashësi të paktën 18 cm dhe kanë izolim akustik dhe termik në mes të murit. Muret janë bërë në mënyrë që izolimi akustik të jetë të paktën 60 dB.

Dritaret janë të punuara me material cilësor, me xham të paktën trishtresor me ura termike dhe joreflektuese. Ato janë të lehta për t'u përdorur dhe për t'u mirëmbajtur si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Dritaret janë dimensionuar për të siguruar hyrjen maksimale të dritës së ditës në klasa dhe për të zvogëluar nevojën për dritë artificiale shtesë.

Dyshemetë janë të përbëra nga materiale PVC antistatike me cilësi të lartë, të cilat janë jo-rrëshqitëse dhe rezistente ndaj zjarrit. Linja e dyshemesë është pak e ngritur drejt murit për mirëmbajtje më të lehtë të sipërfaqeve të dyshemesë dhe vendet e lidhjes së materialit janë të cilësisë së lartë, në mënyrë që të mos grumbullohet papastërtia.

Konstruksioni i çatisë, pa marrë parasysh se për çfarë lloj çatie bëhet fjalë, është i fiksuar mirë në konstruksionin mbështetës ekzistues të objektit dhe i qëndrueshëm ndaj erërave të forta dhe peshës së trashësisë së borës. Nëse konstruksioni mbështetës i çatisë është prej druri, atëherë për ndërtesa më të mëdha sigurohet sektorizimi i sipërfaqes çdo 25 m, me mur rezistent ndaj zjarrit për të paktën 2 orë. Në konstruksionin e nënçatisë bëhet gjithmonë izolimi termik për të shmangur ngrohjen dhe ftohjen e shpejtë të hapësirave nën çati. Mbulimi i çatisë bëhet me materiale që izolojnë depërtimin e ujit dhe janë të lehta për t'u mirëmbajtur.

Të gjitha instalimet elektrike në ndërtesë kryhen ekskluzivisht me kablo vetëshuarëse ndaj zjarrit. Gjatë ndërtimit të shkollave është e detyrueshme të ndiqen standardet ekzistuese në përputhje me Ligjin e ndërtimit, ndërsa i gjithë dokumentacioni duhet të jetë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe inspektoratit kompetent.

3.3 Rikonstruksioni i objektit shkolle

Rikonstruksioni i objekteve shkollore është mundësi për t'i përmirësuar ato dhe për t'i afruar me standardet dhe normat në fuqi, për aq sa e lejojnë kushtet ekzistuese.

¹⁴ Rregullorja e mbrojtjes nga zjarri, shpërthimet dhe materialet e rrezikshme "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 231 të datës 25.9.2020.

Rikonstrukcioni kryhet gjithmonë me materiale cilësore, njësoj si gjatë procesit të ndërtimit të një objekti të ri. Materialet e përdorura për rikonstrukcion janë në përputhje me ato ekzistuese në ndërtesë, në mënyrë që të mos bien në sy dhe të mos bëjnë ndryshim të madh në pamjen dhe cilësinë e brendshme dhe të jashtme ekzistuese të ndërtesës.

4. STANDARDET E PËRGJITHSHME PËR PAJISJET E HAPËSIRËS SË JASHTME TË SHKOLLËS

4.1 Oborri i shkollës

Oborri i shkollës është i organizuar për nevojat e shkollës në përputhje me programet mësimore, ndërsa qasjet drejt ndërtesës së shkollës janë të përcaktuara qartë:

- qasje për nxënësit dhe prindërit,
- qasje për të punësuarit (mësimdhënësit dhe administrata),
- qasje për kuadrin teknik.

Oborret e shkollave shërbejnë si vende grumbullimi, vende pushimi dhe zona rekreative për nxënësit, si dhe për realizimin e një pjese të programit mësimor, ndërsa ndërtesa e shkollës është e pozicionuar në mënyrë të tillë për të lejuar qasje të sigurt të nxënësve. Oborri i shkollës është plotësisht i qasshëm dhe i sigurt për nxënësit me aftësi të kufizuara që përdorin mjete ndihmëse ose mjete të tjera lëvizshmërie. Oborri është i pajisur dhe i rregulluar me shteg me prekje për personat e verbër dhe shtigjet janë të qasshme për nxënësit në karroca.

Në varësi të dendësisë së popullsisë në komunën në të cilën ndodhet shkolla, përcaktohet edhe madhësia e oborrit të shkollës. Për shkollat e nivelit të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të zhvillimit, të cilat ndodhen në komuna me dendësi popullore më të ulët ose të barabartë me mesataren nacionale, oborri është të paktën 25 m² për nxënë. Për shkollat e nivelit të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të zhvillimit, të cilat ndodhen në komuna me dendësi popullore më të madhe se mesatarja nacionale, oborri është të paktën 15 m² për nxënë, por jo më pak se 1,700 m².

Sipërfaqja e oborrit të shkollës i referohet vetëm zonës që ndodhet rreth objektit të shkollës, pra nuk përfshin tokën nën objekte. Oborri është i ndarë në: oborr shkolle me zona të qasshme dhe të gjelbra, terrene sportive, vende parkimi, objekte ndihmëse dhe zona për dorëzimin e mallrave, dhe kopsht shkolle (opsional).

4.1.1 Terrenet sportive

Terrenet sportive për nevojat e procesit arsimor janë të lidhura me shkollën, por larg hapësirave të destinuara për mësim. Në varësi të kushteve natyrore, mikrolokacionit dhe konfigurimit të terrenit, terrenet sportive shkollore janë të orientuara në drejtim veri-jug. Sipërfaqja e kërkuar për fushat e lojërave në oborrin e shkollës është sipas madhësive standarde të fushave të ndryshme sportive, si më poshtë:

Tabela 3. Dimensionet standarde për fushat sportive në varësi të sportit

Sporti	Dimensioni minimal
Futboll	90 m x 45 m
Basketboll	24 m x 13 m
Hendboll	90 m x 55 m
Tenis	23 m x 8 m
Volejbol	18 m x 9 m

4.1.2 Oborr shkolle me hapësira të qasshme dhe të gjelbra

Si hapësira të lira në oborrit e shkollës konsiderohen: hapësirat e mësimi në natyrë, këndi për riciklimin e mbetjeve, sipërfaqja e gjelbër. Përveç kësaj, varësisht nga hapësira, konfigurimi dhe burimet, shkolla rekomandohet të ketë: kopsht shkolle, poligon trafiku dhe objekte ndihmëse. Organizimi dhe rregullimi i hapësirave të lira në oborrit e shkollës varet nga madhësia e tij, e cila përcaktohet nga lloji i ndërtesës së shkollës. Në varësi të vendndodhjes së shkollës (urbane - rurale; e zhvilluar - e pazhvilluar), hapësirat e lira në oborrit e shkollës përfshijnë:

4.1.2.1 Hapësirë për mësimin në natyrë

Në strukturën e oborrit të shkollës duhet të ketë hapësirë të caktuar për mësim në natyrë. Kjo hapësirë duhet të jetë e vendosur në një pjesë të qetë të oborrit. Kjo hapësirë mundësisht duhet të ketë ulëse të fiksuara në formën e amfiteatrit.

4.1.2.2 Kënd për riciklimin e mbetjeve

Në strukturën e oborrit të shkollës është e nevojshme të zgjidhet një vend, i ashtuquajtur "ishull riciklimi", ku do të vendosen kontejnerë për mbledhjen e ndarë të mbetjeve. Kontejnerët në të cilët përzgjidhen mbetjet janë të shënuar me ngjyra përkatëse, në përputhje me rregulloret ligjore.

4.1.2.3 Hapësirë e gjelbër

Ajo është pjesë e sipërfaqes së lirë të oborrit të shkollës, e cila ndodhet përpara ose pas ndërtesës së shkollës. Rregulimi i sipërfaqes së gjelbër është me bar, pemë, bimë në vazo dhe të ngjashme, varësisht nga hapësira e disponueshme.

4.1.2.4 Kopsht shkolle (opsional)

Kopshti i shkollës organizohet sipas nevojave të procesit arsimor dhe programit mësimor. Vendoset në mënyrë që të jetë i ndriçuar mirë nga dielli, i mbrojtur nga era. Kopshti i shkollës duhet të organizohet si kooperativë shkolle në të cilën nxënësit fitojnë njohuri bazë për kopshtarinë, kultivimin e frutave, me zona për eksperimente botanike si dhe zona për kafshë të vogla dhe zogj. Madhësia e kopshtit të shkollës varet nga numri i nxënësve përdorues, për shkollat në komuna me dendësi popullore më të ulët ose të barabartë me mesataren shtetërore, kapaciteti i kopshtit është të paktën 8 m² për nxënësit, ndërsa për shkollat në komuna me dendësi mbi mesataren shtetërore, kapaciteti është të paktën 5 m², por jo më pak se 400 m².

4.1.2.5 Pajisje ndihmëse

Në kuadër të kopshtit të shkollës në vende të caktuara ndërtohen objekte ndihmëse për qëllime të ndryshme (serë, stacion meteorologjik etj.) për të arritur qëllimet edukative në lëndë të ndryshme. Këto objekte janë zakonisht të llojeve të montueshme.

4.1.2.6 Poligon trafiku

Poligoni i trafikut të shkollës është hapësirë në oborrit e shkollës që përdoret për edukimin e trafikut. Poligoni i trafikut ka dy qëllime: të shërbejë për zhvillimin e trajnimit të edukimit të trafikut dhe si poligon për praktikimin e biçikletës. Dimensionet e poligonit trajnues për praktikimin e biçikletës janë 21 m x 9 m.

4.1.3. Objekte dhe sipërfaqe shtesë për dorëzimin e mallrave

Objektet shtesë ndodhen pranë hapësirave të shpërndarjes dhe janë objekte për nevojat e ndërtesës së shkollës, siç janë hapësira e magazinimit, punëtorja për kuadrin teknik që mirëmban objektin e shkollës, hapësira për instalimet termo-teknike për ngrohjen/ftohjen e objekteve shkollore etj.

Gjatë projektimit të ndërtesave të reja ose rikonstruksionit të ndërtesave ekzistuese, rekomandohet që objektet shtesë të sistemohen në bodrume ose në pjesët nëntokësore të ndërtesës së shkollës që të mos zënë shumë vend në oborr.

4.1.3.1 Hapësirat e dorëzimit të mallrave

Oborri ka qasje të veçantë për pranim dorëzim, i ndryshëm nga qasja e nxënësve dhe është planifikuar si hapësirë e veçantë. Madhësia e hapësirës për pranim dorëzim është 15 m² për klasë, por jo më shumë se 300 m².

4.1.4 Parkingjet

Sigurimi i një vendparkimi është kërkesë për ndërtimin e objektit shkollor. Parkingu është vend për parkimin e makinave dhe biçikletave dhe është në përputhje me rregulloret e përcaktuara në Rregulloren e standardeve dhe normave të planifikimit urban.

4.2 Kushte të tjera që lidhen me vendndodhjen

Ndërtesa e shkollës ka formë drejtkëndëshe dhe është ndërtuar në vendndodhje të destinuar për shkollë fillore, me raport të përafërt të sipërfaqeve prej 1:2. Vendndodhja ka qasje direkte në zonë publike, por mundësisht me frekuencë të ulët trafiku.

Shkolla fillore është e rrethuar me gardh dhe ka një portë – hyrje dhe dalje e kontrolluar nga një parapet muri me lartësi maksimale prej 80 cm në zonat rurale, ose lartësi minimale të gardhit prej 150 cm në zonat urbane. Lejohet të instalohet gardh bimësh në kombinim me gardh me tela nën të njëjtat kushte.

Porta duhet të jetë e lëvizshme dhe të ketë rrota në përputhje me pamjen e përgjithshme të gardhit dhe duhet të hapet nga brenda shkollës.

Fushat sportive duhet të rrethohen me rrjetë mbrojtëse deri në një lartësi maksimale prej 3 m.

5. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR PAJISJEN E KLASAVE

Normizimi i pajisjeve të shkollave fillore nëntëvjeçare kryhet sipas tipizimit të shkollave. Në përputhje me numrin, llojet dhe qëllimin e hapësirave, të parashikuara në secilin lloj ndërtese shkollore, përcaktohet numri, lloji dhe madhësia e mobilieve shkollore (karrige, banka, dërrasa, tavolina, dollapë etj.), kurse në përputhje me madhësinë e oborrit, përcaktohet qëllimi i sipërfaqeve të lira të tij në oborrin e shkollës (terrenet sportive, poligonet e trafikut etj.).

Niveli i zhvillimit të shkollës merret në konsideratë si kriter për pajisjen e shkollave me llojin e mobilieve që, pavarësisht nga lloji i ndërtesës shkollore (hapësirave në dispozicion), ka shkolla (tavolina dhe banka shkollore dhe karrige për nxënësit).

Gjatë shtimit, zgjerimit ose rikonstruksionit të një ndërtese shkollore të një lloji tjetër, ndiqen normat e përfshira në këtë normativë.

5.1 Furnizimi i klasës

5.1.1 Klasa universale


Klasat për të gjithë nxënësit nga klasa I deri në IX, pra për nxënësit e moshës 6 deri në 14 vjeç, janë të barabarta.

Sa i përket vendndodhjes, klasa universale është afër hyrjes ose me një hyrje të jashtme të veçantë nga jashtë; në katin përdhes ose në katin e parë (me qasje të siguruar për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore); klasa universale në shkollën fillore nëntëvjeçare është e pajisur me mobiliat e mëposhtme: banka shkollore, karrige për nxënësit, karrige dhe tavolinë zyre për mësimdhënësin; dërrasë rë zezë shkolle, dollap për klasën, rafte, dërrasë inteligjente/televizor inteligjent/ekran projektimi dhe projektor LCD, laptop, bilbord ekspozimi.

Po ashtu, në shkollë sigurohet qasje në pajisjet dhe instrumentet që janë të destinuara për kryerjen e eksperimenteve dhe për mbështetjen e aktiviteteve mësimore kërkimore në lëndët e rregullta, si dhe për realizimin lëndëve zgjedhore të lira.

Periudha e parë arsimore: klasa për klasat e para, të dyta dhe të treta është e pajisur me pajisjet e mëposhtme: banka shkollore; tavolinë me rregullim lartësie dhe këndi për nxënësit me aftësi të kufizuara (për nxënës me nevoja të veçanta arsimore); karrige; dollap për mjetet mësimore, literaturë etj., me vitrinë dhe kaseta të mbyllura që përdoren nga mësimdhënësi/ja; rafte të hapura për lodra të arritshme nga nxënësit, dollap i vogël me rrota; tavolinë e vogël kompjuteri; bilborda; dërrasë muri; dërrasë inteligjente/televizor inteligjent/ekran projeksioni; projektor LCD, laptop, kanavacë për pikturim; furnizim dhe shkarkim uji (lavaman); karrige për mësimdhënësin.

Figura 2. Propozim për klasën standarde për periudhën e parë zhvillimore




Gjatë organizimit të hapësirës në periudhën e parë zhvillimore, mësimezhënësi kujdeset të mbikëqyrë çdo pozicion dhe çdo aktivitet në klasë në çdo kohë dhe nga çdo kënd. Hapësira është gjithmonë e sigurt, e pastër, e rregulluar dhe e ndarë në disa zona mësimore që përmbajnë materiale të ndryshme. Klasa është e ndarë në disa pjesë dhe secila pjesë duhet të paraqesë një kënd për çdo fushë të caktuar. Këndet e mësimi në klasë janë si më poshtë:

- këndi i letërsisë/dramës;
- këndi i matematikës/ndërtimit;
- këndi i kërkimit;
- këndi i krijimtarisë/artit;
- këndi i dëgjimit të muzikës;
- këndi i familjes;
- kënd i lojërave me sende të vjetra;
- këndi i kompjuterit/IT-së.

Shpërndarja e mobilieve mbështet pavarësinë e nxënësve dhe sfidat e reja të të mësuarit.

Figura 3. (a); (b); (c) Skicë e propozuar për grupimin e bankave me forma të ndryshme për periudhën e parë të zhvillimit



(a)

(b)

(c)

Në periudhën e dytë arsimore përdoren pajisjet standarde të klasës për klasat e katërta, të pesta dhe të gjashta dhe është e nevojshme të ketë të njëjtat pajisje si të renditura në klasën universale. Përveç kësaj, në këtë periudhë zhvillimore është e nevojshme të përdoren kabinetet për fushat e shkencave natyrore dhe artit me mësimdhënësin e lëndës nga klasa e pestë, dhe sipas nevojës dhe sipas mundësive në objektin e shkollës, kabinetet për fushën matematikore, gjuhësore dhe shoqërore.

Në periudhën e tretë arsimore përdoren pajisjet standarde të klasës për klasat e shtata, të teta dhe të nënta, të renditura në klasën universale. Mësimi në periudhën e tretë arsimore si rregull realizohet në kabinete, si më poshtë:

- Kabinet për lëndët në fushën e matematikës;
- Kabinet për lëndët në fushën gjuhësore (gjuhët e mësimi dhe gjuhët e huaja);
- Kabinet për lëndët në fushën shkencor-natyrore (biologji, kimi, fizikë dhe gjeografi - përveç pajisjeve standarde, në këto kabinete duhet të sigurohet furnizimi me ujë dhe shkarkim, si dhe furnizimi me energji elektrike (ose gaz), me ventilator për pastrimin e ajrit, pajisje për fikjen e zjarrit dhe një kuti e ndihmës së shpejtë);
- Kabinet për lëndët në fushën sociale (histori dhe shoqëri); dhe
- Kabinet për lëndët në fushën e artit (muzikë, art figurativ).

5.1.1.1 Bankat dhe karriget shkollore


Bankat dhe karriget e shkollës janë pjesë thelbësore e mobilieve shkollore.

Bankat dhe karriget e shkollës janë të lëvizshme dhe të përpunuara nga materiale që lejon lëvizjen dhe rregullimin e lehtë në klasë sipas nevojave të mësimi. Sipërfaqja e sipërme horizontale e bankës është rezistente ndaj nxehtësisë, kimikateve dhe ujit. Nën banka ka një raft të hapur për ruajtjen e furnizimeve të nxënësve. Gjithashtu, për nxënësit me aftësi të kufizuara ka një banka me rregullim të lartësisë dhe këndit të sipërfaqes së punës. Çdo bankë shoqërohet me një karrige. Ulësja dhe mbështetësja e karriges janë prej druri, ndërsa pjesët e tjera janë prej metali.

Për nxënësit e klasës së parë deri në të tretën në periudhën e parë zhvillimore, bankat shkollore janë drejtkëndëshe, katrore, rrethore ose në formë romboide (duke i bashkuar ato, fitohet një tavolinë rrethore) me dimensione si ato të listuara në Figurën 4. Paraqitje skematike e lartësisë së karrigeve dhe tavolinave (*Dimensionet e një banke shkollore për nxënësit nga tri periudhat zhvillimore*) për

klasën e parë, të dytë dhe të tretë. Numri i bankave shkollore në një klasë përcaktohet sipas kapacitetit të klasës.

Figura 4. Paraqitje skematike e lartësisë së karrigeve dhe bankave



5.1.1.2 Tavolina e punës dhe karrigia e mësimdhënësit

Tavolina e mësimdhënësit është pjesë e mobilieve shkollore me të cilat mobilohen klasat. Ajo i shërben mësimdhënësit, përveç për punët administrative, edhe si tavolina demonstruese, prandaj sipërfaqja horizontale e sipërme është rezistente ndaj nxehtësisë, kimikateve dhe ujit.

Tavolina e mësimdhënësit është e përpunuar nga material që mundëson zhvendosjen e saj të lehtë dhe përshtatjen në planin e bankave që kërkohet nga organizimi i duhur i punës mësimore.

Dimensionet e tavolinës janë të ngjashme me madhësinë më të madhe të një tavoline shkolle. Me tavolinën gjendet gjithashtu e bashkangjitur edhe karrigia.

Me tavolinë për mësimdhënësin furnizohen edhe klasata e specializuara për të gjitha lëndët, si dhe hapësirat e punës për mësimdhënësit.

Po ashtu ekziston edhe një tavolinë drejtkëndëshe, me përmasa: lartësi 64 cm, ndërsa dimesionet për sipërfaqen e sipërme janë 80/120 cm për akomodimin e pajisjeve kompjuterike.

Për të gjitha periudhat e zhvillimit, tavolina dhe karrigia e mësimdhënësit janë të njëjta.

5.1.1.3 Dërrasa e zezë e klasës

Me dërrasë të zezë shkolle pajisen jo vetëm klasat universale, por edhe hapësirat e tjera mësimore, siç janë klasat e specializuara për të gjitha lëndët mësimore. Dërrasat standarde të shkollave janë me gjatësi 200 cm të gjata dhe 120 cm të lartë, përkatësisht 4 m². Skaji i poshtëm i dërrasës është i ngritur nga dyshemeja afërsisht 90 cm.

Përveç kësaj dërrase standarde, si dërrasë statike konsiderohet edhe dërrasa friz. Kjo dërrasë ka formë drejtkëndore dhe zë të gjithë gjerësinë e murit të përparmë. Si rregull, ajo ndahet me anë të shenjave të veçanta (linja ose shirita) në disa pjesë, dhe në bazë të kësaj, secila pjesë shërben për një qëllim specifik (për lëndën e matematikës, të gjuhës amtare, të edukimit muzikor etj.).

Ekzistojnë disa lloje dërrasash shkollore: plotësisht të lëvizshme, gjysmë të lëvizshme, statike, përkatësisht të fiksuara plotësisht në murin e përparmë të klasës. Ekzistojnë dërrasa, qëllimi i të cilave është universal (përdoren në të gjitha lëndët mësimore) dhe dërrasa, pjesët e të cilave janë të destinuara për lëndë mësimore individuale (dërrasa të kombinuara).

Dërrasa të zeza plotësisht të lëvizshme


Dërrasa vertikalisht të lëvizshme, në fakt, janë një kombinim i dy dërrasave: njëra e fiksuar në mur dhe e lëvizshme në drejtim vertikal, ose dy dërrasa që janë të lëvizshme në drejtim vertikal.

Dërrasat horizontalisht të lëvizshme ndërtohen në dy mënyra: 1) dërrasa horizontale me dy krahë të fiksuar dhe një krah të mesëm që lëviz në të dyja anët, edhe majtas dhe djathtas, me anë të secilës palos të dy krahët e fiksuar; 2) dy krahë të lëvizshëm.

Dërrasa të zeza gjysmë të lëvizshme

Ekzistojnë dy lloje dërrasash shkollore gjysmë të lëvizshme. Në këto dërrasa, një pjesë është e fiksuar, ndërsa pjesët e tjera janë të lëvizshme. Pjesët e lëvizshme të tabelës lëvizin në drejtim vertikal dhe horizontal. Ato janë të fiksura në murin e përparmë të klasës. Dërrasat e fiksura janë statike dhe më shpesh vendosen në murin e përparmë të klasës. Dimensionet e dërrasave shkollore ndryshojnë. Si rregull, dërrasa është rreth 4 m² e madhe.


Figura 5. Skica për vendosjen e dërrasës shkollore dhe asaj të mençur me tavolinën e mësimit dhe dollapin e klasës për periudhën e dytë dhe të tretë të zhvillimit



Periudha e parë arsimore: Dërrasa e murit për nxënësit e klasave të para, të dyta dhe të treta vendoset në mënyrë që skaji i poshtëm të jetë 50 cm nga dyshemeja. Sipërfaqja është e lëmuar, jo e zezë, pa shkëlqim, me refleksion deri në 20%.

Për këtë periudhë zhvillimore përdoret edhe trekëmbëshi (dërrasë e lëvizshme), i cili mund të zhvendoset në pjesë të ndryshme të klasës sipas nevojës, ndërsa përdoret gjithashtu për aktivitete të ndryshme në klasë. Këto janë dy dërrasa të vendosura në mbajtëse trekëmbëshi deri në 120 cm të lartë.

Figura 6. Skica për vendosjen e dërrasës shkollore dhe asaj të mençur me tavolinën e mësimit dhe dollapin e klasës për periudhën e parë të zhvillimit



5.1.1.4 Dërrasa elektronike/inteligjente/panel interaktiv

Dërrasa elektronike përdoret në kuadër të aktiviteteve për të zhvilluar mësim interaktiv dhe për të krijuar mundësi për arsimim më të mirë për të gjithë nxënësit. Dërrasa elektronike ka karakteristikat e mëposhtme:

- diagonalja e sipërfaqes aktive: min. 65",
- raporti: min. 4:3,
- korniza: alumin, me mundësinë e heqjes nga sipërfaqja e përparme,
- sipërfaqja e ekranit: sipërfaqe mat (jorefleksive) rezistente ndaj ndikimeve të jashtme, elektronikisht joaktive, e ndjeshme ndaj prekjeve,
- mundësi shkrimi me laps shënues për dërrasë të bardhë.

Paneli interaktiv ka sipërfaqe minimale prej 65".

5.1.1.5 Dollapi i klasës

Dollapi i klasës është pjesë integrale e pajisjeve të klasës universale dhe të specializuara. Ai shërben për të mbajtur fletoret e nxënësve për punimet me shkrim; pikturat e nxënësve; punimet praktike të nxënësve; librat nga biblioteka referuese e nxënësve; materialet didaktike të përgatitura dhe të përdorura nga mësimdhënësi; mjetet mësimore të përdorura gjatë ditës ose orës mësimore; pajisjet për ushtrime të ndryshme etj.

Dollapët e klasës janë të përshtatshëm për moshën e nxënësve në mënyrë që të përdoren lehtësisht, janë përpunuar nga material i lehtë, kanë numër të mjaftueshëm raftesh dhe janë të lëvizshëm. Ata vendosen në vendin më të përshtatshëm të klasës.

Për periudhën e parë zhvillimore, dollapi i klasës është pjesë integrale e pajisjeve të klasës në klasat e para, të dyta dhe të treta dhe ka këto përmasa: lartësi 70 cm dhe gjerësi 90 cm.

Klasa ka edhe dollap të hapur me këto përmasa: lartësi 120 cm, gjerësi 50 cm, distanca midis rafteve është 68 cm, si dhe një dollap për mjete edukative, literaturë dhe të ngjashme me përmasa standarde: lartësia 207 cm dhe gjerësia 82 cm.

5.1.1.6 Bilborda me raft për ekspozim

Gjatë mësimit mësimdhënësi demonstroi mjete mësimore, fotografi, vizatime, grafikë, harta gjeografike etj. Për këtë qëllim është përshtatur bilbord i veçantë ekspozimi. Bilbordi vendoset në vend të dukshëm në klasë. Bilbordi përbëhet nga dy pjesë: pjesa e lëvizshme që shërben për të shfaqur (prezantuar) objekte, mjete mësimore etj. dhe një pjesë fikse që është e ngjitur në mur dhe mbi të cilën vendosen varëse në vende të caktuara, të cilat shërbejnë për të demonstruar fotografi, vizatime, harta etj.

Bilbordi ekspozues është prej druri ose plastike, ndërsa sipërfaqja e përparme zakonisht është e veshur me material tape, për ngjitje më të lehtë të materialeve grafike didaktike të ekspozuara. Në klasë ka bilbord ekspozues, sipas nevojave të mësimdhënies.

Në periudhën e parë të zhvillimit, bilbordi për klasën e parë, të dytë dhe të tretë është i përbërë prej jute ose pëlure të trashë me kornizë, e cila varet në mur (në lartësi prej 50 cm deri në 60 cm nga dyshemeja deri në skajin e poshtëm) me gjatësi prej 50 cm deri në 150 cm dhe lartësi prej 80 cm deri në 100 cm.

5.1.1.7 Ekran për projeksione

Ekran i projekcionit paraqet një kanavacë të bardhë me trekëmbëshin e vet. Mund të mbështillet lehtësisht, të transportohet dhe të vendoset në hapësirën e dëshiruar. Dimensionet e tij janë afërsisht 2.5 m x 1.5 m.

Tabela 6. Pajisjet e shkollave fillore me nga një paralele për secilën klasë

Niveli i zhvillimit	Llojet e pajisjeve								
	Klasat	Banka	Karrige	Mësimdhënës	Karrige për mësimdhënësit	Dërrasa	Dollap për nxënësit	Raft demonstrimi	Ekran për projeksione
Shkolla fillore nëntëvjeçare me nga një paralele nga secila klasë, gjithsej 9 klasa	I	15-30	30	1	1	1	1	1	1
	II	15	30	1	1	1	1	1	1
	III	15	30	1	1	1	1	1	1
	IV	15	30	1	1	1	1	1	1
	V	15	30	1	1	1	1	1	1
	VI	15	30	1	1	1	1	1	1
	VII	15	30	1	1	1	1	1	1
	VIII	15	30	1	1	1	1	1	1
	IX	15	30	1	1	1	1	1	1
	Gjithsej:	135- 270	270	9	9	9	9	9	9

Numri i nxënësve për paralele varet edhe nga niveli i zhvillimit të shkollës. Ndryshimi i numrit të paraleleve ose ndryshimi i numrit të klasave në to (rritje ose ulje) nënkupton edhe ndryshim përkatës në pajisje (mobilitet).

6. Mjete mësimore bazë dhe materiale didaktike

Mjetet mësimore dhe materialet didaktike thjeshtojnë ose lehtësojnë aktivitetet mësimore dhe janë resurse që mësimdhënësi i përdor gjatë realizimit të procesit të mësimi. Ato përdoren fizikisht ose virtualisht dhe kanë për qëllim stimulimin dhe zhvillimin e nxënësve. Mësimdhënësi, një grup mësimdhënësish ose botues të specializuar përgatisin materialin didaktik. Për secilën periudhë zhvillimore përcaktohen mjetet mësimore dhe materialet didaktike të nevojshme.

6.1 Periudha e parë arsimore (nga klasa e parë deri në të tretën)

Në periudhën e parë arsimore, çdo klasë ka:

- kompjuter;

- dërrasë elektronike/dërrasë të mençur /televizor të mençur;
- fletë mësimore, pankarta, postera, ilustrime me fotografi (të ndara ose në seri) që lidhen me përmbajtjen dhe aktivitetet e secilës lëndë mësimore;
- rekuizita (pazëlla, kuba të vegjël, labirinte etj.).

Për realizimin e procesit edukativo-arsimor, përveç mjeteve mësimore dhe materialeve didaktike të përmendura, përdoren edhe materiale të tjera të cilat janë të renditura në programet mësimore.

Pavarësisht nëse ka apo jo nxënës me aftësi të kufizuara në shkollë, shkolla fillore është e detyruar të sigurojë mjete mësimore dhe materiale didaktike për nxënësit me aftësi të kufizuara, të përshtatshme për nevojat e tyre.

6.2 Periudha e dytë arsimore (nga klasa e katërt deri në të gjashtën)

Në çdo klasë të periudhës së dytë arsimore, mjetet bazë mësimore dhe materialet didaktike janë:

- kompjuter;
- dërrasë elektronike/dërrasë e mençur/televizor i mençur;
- fletë mësimore, pankarta, postera, ilustrime me fotografi (individuale ose në seri) që lidhen me përmbajtjen dhe aktivitetet e secilës lëndë mësimore;

Për realizimin e procesit edukativo-arsimor, përveç mjeteve mësimore dhe materialeve didaktike të përmendura, përdoren edhe materiale të tjera të cilat janë të renditura në programet mësimore.

Për nxënësit me aftësi të kufizuara sigurohen mjetet mësimore dhe materialet didaktike sipas nevojave të tyre.

6.3 Periudha e tretë arsimore (nga klasa e shtatë deri në të nëntën)

Në çdo klasë të periudhës së tretë arsimore, mjetet bazë mësimore dhe materialet didaktike janë:

- kompjuter;
- dërrasë elektronike/dërrasë e mençur/televizor i mençur;
- fletë mësimore, pankarta, postera, ilustrime me fotografi (individuale ose në seri) që lidhen me përmbajtjen dhe aktivitetet e secilës lëndë mësimore;

Për realizimin e procesit edukativo-arsimor, përveç mjeteve mësimore dhe materialeve didaktike të përmendura, përdoren edhe materiale të tjera të cilat janë të renditura në programet mësimore.

Për nxënësit me aftësi të kufizuara sigurohen mjetet mësimore dhe materialet didaktike sipas nevojave të tyre.

Këto norma dhe standarde hyjnë në fuqi në ditën e tetë nga dita e miratimit të tyre.

Për objektet ekzistuese të shkollave fillore **për të cilat janë përgatitur studime të qëndrueshmërisë ose dokumentacion projekti, ose ka filluar rikonstrukcioni/adaptimi/sanimi/zgjerimi, para miratimit të këtyre normave**, do të zbatohen Normativat dhe standardet për hapësirat, pajisjet dhe mjetet mësimore për shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut të miratuara me Vendimin nr. 18-6466/2 të datës 10.7.2020.

Ministrja e Arsimit dhe Shkencës

Prof. dr. Vesna Janevska